

STATUT
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR
“NEVA INVEST GROUP”

Neni 1
Emri dhe Forma

1.1 Shoqëria do të ketë emrin **“NEVA INVEST GROUP” SH.P.K** dhe do të jetë me formë ligjore: Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar **“SH.P.K”** (më poshtë e quajtur **“Shoqëria”**).

Neni 2
Selia

2.1 Shoqëria e ka selinë në adresën: *“Tiranë, Fshati Gropaj, Godina Tirana Cash & Carry, Kati 2, Vaqarr, Tiranë.”*

Neni 3
Objekti i Veprimtarisë

3.1 *“Investime në fusha të ndryshme, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë; Import dhe eksport të produkteve ushqimore dhe industriale; Shërbime dhe konsulencë financiare, juridike, ndërmjetësimi, tregtare, fiskale, studime tregu, fizibiliteti, hartimi i planeve të biznesit, shërbime imobiliare, hoteleri, blerje dhe shitje të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, marrja dhe dhënia me qira e objekteve të të treteve, perfaqësime tregtare për biznese vendase dhe të huaja. Çdo veprimtari tjetër të lejuar nga ligji dhe/ose pjesëmarrjen në çdo veprimtari apo aktivitet të ligjshëm që mund të kryejë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar në bazë të legjislacionit Shqiptar.*

3.2 Për realizimin e objektit të veprimtarisë Shoqëria mund:

- a) të themelojë partneritete për kryerjen e investimeve dhe shërbimeve si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
- b) të lidh kontrata me klientët qoftë person fizik ose juridik, Shqiptarë apo të huaj, që jetojnë në Shqipëri apo shtete të tjera;
- c) të marrë pjesë me aksione/kuota edhe në shoqëri të tjera vendase, të huaja ose me kapital të përbashkët që kanë objekt shoqëror dhe aktivitet të ngjashëm me të;
- d) të krijojnë shoqëri, filiale dhe zyra përfaqësie në qytete të tjera të Shqipërisë ose në shtete të tjera, në përputhje me legjislacionin e tyre.

3.3 Në mënyrë që të arrihet qëllimi i sipërpërmendur, Shoqëria mund:

- a) të kryejë çdo aktivitet tregtar, financiar, investim, dhënie-marrje me qira, të vendosë pengje dhe barrë hipotekore; aktivitete këto të konsideruara si të dobishme apo të nevojshme dhe që nuk tejkalojnë në masë aktivitetet kryesore, të cituara më sipër;
- b) të kryejë aktivitete publikimi dhe reklamimi.



- 3.4 Shoqëria kryen çdo lloj aktiviteti që bën pjesë në objektin e saj, që lidhet me të dhe që e mbështet atë.
- 3.5 Shoqëria zbaton të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore të duhura. Ajo zbaton standartet më të larta të etikës.
- 3.6 Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj në çdo kohë siç parashikohet në Statut.

Neni 4
Kohëzgjatja

- 4.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj pa afat të caktuar.

Neni 5
Kapitali Themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërisë është 10.000.000 (dhjetë milion lekë), i cili zotërohet 100% nga ortaku i vetëm themelues.

Neni 6
Ortakët e Shoqërisë dhe Kuotat

- 6.1 Ortaku i vetëm i shoqërisë është shoqëria “BigAlb Group” Sh.p.k.
- 6.2 Shoqëria “BigAlb Group” Sh.p.k 1 kuotë me vlerë 10.000.000 (dhjetë milion lekë), e cila përbën 100% të kapitalit fillestar të shoqërisë.

Neni 7
Zmadhimi ose Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

- 7.1 Kapitali mund të zmadhohet ose të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në përputhje me përcaktimet e këtij Statuti dhe kërkesave të detyrueshme të Ligjit për shoqëritë tregtare.
- 7.2. Zmadhimi i kapitalit mund të realizohet me anë të kontributeve në para, me anë të kontributeve në natyrë ose me përfshirjen e rezervave (nëse ka) dhe fitimit.
- 7.3. Pjesët e reja të kapitalit themeltar do të nënshkruhen dhe vlera e tyre nominale do të paguhet plotësisht.
- 7.4 Zmadhimi i kapitalit nuk do të dobësojë pjesët e interesit të Ortakëve në kapitalin e shoqërisë, përveçse kur Ortakët do të bien dakord ndryshe me vendim unanim të Ortakëve.
- 7.5 Shoqëria nuk mund të blejë asnjë kuotë të saj. Megjithatë, me qëllim zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, nëpërmjet vendimit për zvogëlimin e kapitalit, Ortakët mund të autorizojnë Administratorin/Administratorët të bëjnë blerjen e kuotave përkatëse dhe ti anulojnë ato.



Neni 8

Të Drejtat dhe Detyrimet e Ortakëve

- 8.1 Ortakë janë vetëm ata të cilët zotërojnë kuota në Shoqëri.
- 8.2 Çdo kuotë i jep të drejtën e një vote çdo Ortaku, në Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve (Asambleja e Përgjithshme), të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në organet drejtuese, të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen e fitimeve të Shoqërise, sikundër të drejtat e parashikuara nga ky Statut, për çdo marrëveshje të detyrueshme ndërmjet Ortakëve dhe dispozitave ligjore të Ligjit për shoqëritë tregtare.
- 8.3 Ortakëve do t'u jepen, vetëm nëpërmjet kërkesës me shkrim, informacione dhe të dhëna në lidhje me aktivitetin e Shoqërisë në çdo kohë, duke përfshirë të drejtën që të kontrollojnë dokumentat dhe raportet e Shoqërisë.
- 8.4 Të drejtat dhe detyrimet që rezultojnë nga zotërimi i Kuotave, transferohen tek çdo zotërues i ri për këto Kuota.
- 8.5 Detyrimet e Shoqërisë janë të garantuara nga kapitali i saj dhe Ortakët mundet të mbajnë përgjegjësi vetëm brenda limitit të vlerës së kuotave që ata zotërojnë; Ortakët nuk mbajnë përgjegjësi për detyrime që tejkalojnë investimin e tyre përkatësisht në kapitalin e Shoqërisë (përveç garancive dhe huave që ata realizojnë).
- 8.6 Shoqëria nuk mban përgjegjësi për borxhe ose detyrime të tjera të Ortakëve të tij.

Neni 9

Transferimi i Pjesëve të Kapitalit

- 9.1 Pjesët e kapitalit transferohen lirisht midis ortakëve.
- 9.2 Në rast se një Ortak do të shesë, transferojë, ose përdorë në mënyra të ndryshme ndonjë, disa ose të gjithë kuotat e tij ("Shitësi"), ai duhet që të marrë paraprakisht miratimin e Asamblesë së Përgjithshme e cila duhet të vendosë me një shumicë që përfaqëson të paktën 75 % (shtatëdhjetë e pesë përqind).
- 9.3 Me anë të këtij Statuti krijohet një "Libër i Ortakëve", ku të gjithë Ortakët mund të regjistrojnë kuotat që ato zotërojnë në Shoqëri. Në mënyrë që të konsiderohen si Ortakë, çdo person që siguron zotërimin e një ose më shumë kuotave të Shoqërisë duhet të regjistrojë emrin në Librin e Ortakëve.
- 9.4 Çdo hyrje në libër do të tregojë emrin e Ortakut, shumën e kuotës që një Ortak i caktuar zotëron dhe formën e transaksionit nëpërmjet së cilës është siguruar ky zotërim. Libri mbahet nga Administratori i Shoqërisë, i cili duhet t'i leshojë një kopje të njëjtë secilit Ortak që e kërkon. Çdo hyrje në liber regjistrohet dhe nënshkruhet nga Administratori i Shoqërisë, pasi të paraqitet nga Ortaku përkatës dokumenti që vërteton zotërimin e kuotave prej tij.
- 9.5 Çdo transferim i kuotave do të bëhet në përputhje me dispozitat e Ligjit të Shoqërive dhe duhet të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Asambleja e Përgjithshme

Neni 10

Kompetencat

- 10.1 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi drejtues i Shoqërise i cili merr vendimet

mbi aktivitetin dhe politikat e saj ekonomike dhe tregtare.

- 10.2 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve vendos në lidhje me çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - ç) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
 - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 10.3 Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ë" të pikës së këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumentëve përkatës.
- 10.4 Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

Neni 11

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

- 11.1 Asambleja e Përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligji për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, nga dispozitat e Statutit apo sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.
- 11.2 Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e saj.
- 11.3 Asambleja e Përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- 11.4 Asambleja e Përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 11.5 Asambleja e Përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 vitëve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 11.6 Në rastet e parashikuara në pikat 3 e 5 të këtij neni, Asamblesë së Përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur.

Neni 12

Mënyra e Thirrjes

- 12.1 Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga Statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik



duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë Ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë.

- 12.2 Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë Ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 13 **Kuorumi**

- 13.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë Ortakët me të drejtë votë, që zotërojnë më shumë se 50 për qind të kuotave. Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse Ortakët që zotërojnë më shumë se 60 për qind të kuotave, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të ligjit për shoqëritë tregtare. Në rastin kur për marrjen e vendimeve kërkohet unanimitet, Kuorumi i nevojshëm është mbi 70 për qind të kuotave.
- 13.2 Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së Kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, Asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 14 **Marrja e Vendimeve**

- 14.1 Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, Asambleja e Përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të Ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e Statutit, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 14.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj ose në statut, për çështjet e tjera, Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të Ortakëve pjesëmarrës.
- 14.3 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi Ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë statut, kushtëzohet nga miratimi i Ortakut përkatës.
- 14.4 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve vendos/aprovon me unanimitet:
- a) buxhetin (bilancin/pasqyrat financiare)
 - b) zmadhim dhe zvogëlim kapitali, financimin e ortakëve, apo financim nga bankat;
 - c) Opex Capex tej buxhetit të parashikuar;
 - d) çdo kontratë apo pagesë mbi limitin e shumës së kapitalit të derdhur;
 - e) blerje apo shitje të pasurive/aseteve të shoqërisë.

Neni 15 **Përjashtimi nga e Drejta e Votës**

- 15.1 Një Ortak përjashtohet nga e drejta e votës në rastin kur Asambleja e Përgjithshme është duke vendosur mbi:
- a) vlerësimin e veprimtarisë së këtij Ortaku.
 - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij.



- c) ngritjen e një padie kundër tij, nga Shoqëria.
 - d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
- 15.2 Kur ky Ortak është i përfaqësuar nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi sikundër Ortaku të cilin përfaqëson.

Administratori

Neni 16

Emërimi dhe Kohëzgjatja

- 16.1 Administratori i Shoqërise do të jetë: Znj. Françeska Sinaj, e bija e Vullnet dhe Miranda, lindur më 27.03.1995 lindur në Vlorë dhe banuese në Tiranë, me kombësi dhe shtetësi Shqiptare, madhor me zotësi juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me Numër Personal J55327061L, Email f.sinaj@bigalbgroun.al dhe Numër Telefoni +355697033013.
- 16.2 Kohëzgjatja e funksionit të Administratorit është 5 (pesë) vjet, me të drejtë ripërtëritje mandati, sipas vendimit të Asamblese së Ortakëve.
- 16.3 Menjëherë pas pranimit të emërimit të tij, Administratori pranon se marrëdhënia e tij me Shoqërinë ndërtohet mbi baza mirëbesimi; lidhur me këtë, vendimi për heqjen e tij nëpërmjet një rezolute të Ortakëve gjykohet si arsye e ligjshme për shkarkim, në përputhje me ligjet përkatëse.
- 16.4 Ortakët kanë të drejtën të emërojnë, lirojnë/shkarkojnë Administratorin, në çdo kohë, me shumicë të thjeshtë votash.

Neni 17

Kompetencat dhe Detyrimet

- 17.1 Kompetencat e Administratorit në kuadër të përfaqësimit të Shoqërisë përfshijnë:
- a) kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
 - b) përfaqëson shoqërinë;
 - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë; përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
 - d) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - e) kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
 - f) raporton përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë;
 - g) kryen detyra të tjera të përcaktuara në Statut dhe në ligjin për Shoqëritë Tregtare.

Neni 18

Detyrimi i Besnikërisë dhe Përgjegjësia



18.1. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 16, 17 e 18 të Ligjit të Shoqërive Tregtare, administratori detyrohet:

- a) të kryej detyrat e tij të përcaktuara në këtë Statut dhe në ligj në mirëbesim e në interesin më të mirë të Shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të vecantë veprimtarisë së Shoqërisë;
- b) të ushtrojë kompetencat që i/u njihen me ligj, nga ky Statut, ose nga Ortakët e shoqërisë vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet për të cilat merret vendim;
- d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ato të Shoqërisë;
- e) të ushtroj detyrat me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm.

18.2. Administratori gjatë kryerjes së detyrave, përgjigjet kundrejt shoqërisë për çdo veprim apo mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e Shoqërisë, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi apo mosveprimi është kryer në mirëbesim.

18.3. Në rast të shkeljes së detyrës dhe standardeve profesionale, Administratori është i detyruar të dëmshpërblejë Shoqërinë, për dëmet që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë Shoqërisë cdo fitim personal që ka realizuar gjatë kryerjes së këtyre veprimeve të parregullta. Ai ka barrën e provës për të vërtetuar se kryen detyrat e tij në rregull dhe sipas standardeve. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një Administrator ata përgjigjen ndaj Shoqërisë në mënyrë solidare.

18.4. Në vecanti, Administratori është i detyruar të dëmshpërblejë Shoqërinë, për dëmet, nëqoftëse në kundërshtim me këtë statut si dhe Ligjin për Shoqëritë tregtare kryen veprimet e mëposhtme:

- a) i kthen Ortakëve kontributet;
- b) i paguan Ortakëve interesa apo dividendë;
- c) i shpërndan asetet Shoqërisë;
- d) lejon që Shoqëria të vazhdojë aktivitetin e saj, kur duhet ta kishte parashikuar që kjo e fundit nuk do të kishte aftësi pagueuese për të shlyer detyrimet e saj;
- e) jep hua;
- f) çdo veprim tjetër të kundraligjshëm në dëm të interesave apo imazhit të Shoqërisë.

Neni 19

Kufizimi i Tagrave të Administratorit

19.1 Administratori do të mund të administrojë dhe menaxhojë aktivitetin tregtar të Shoqërisë në përmbushje të detyrave të zakonshme, përvec administrimit apo detyrave të jashtëzakonshme, apo ato detyra të cilat kërkojnë miratim paraprak të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të kësaj Shoqërie, atëherë kur kjo e fundit voton me unanimitet sipas këtij Statuti.

Administrimi Financiar i Shoqërisë

Neni 20

Eksperti Kontabël i Autorizuar



- 20.1 Ortakët duhet të caktojnë ekspertin kontabël të autorizuar në numrin dhe kohëzgjatjen e përcaktuar nga legjislacioni shqiptar.
- 20.2 Ekspertët duhet të kryejnë funksionet audituese në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Aktiviteti i Shoqërisë

Neni 21

Viti Ekonomiko-Financiar

- 21.1 Viti Ekonomiko-Financiar fillon në ditën e parëtë muajit Janar dhe përfundon në ditën e 31-t të muajit Dhjetor të secilit vit. Viti i parë financiar nis në datën e themelimit të Shoqërisë.

Neni 22

Mbajtja e Llogarive

- 22.1 Shoqëria do të mbajë llogaritë në lekë dhe në monëdhë të huaj.

Neni 23

Llogaritja dhe Shpërndarja e Fitimit

- 23.1 Fitimi i Shoqërisë përcaktohet në bazë të bilancit të aprovuar nga Asambleja e Përgjithshme. Shpërndarja e fitimit do të caktohet nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me Statutin, marrëveshjen e Ortakëve dhe me ligjet e zbatueshme.
- 23.2 Nga fitimet vjetore, do të caktohet një fond rezervë në përputhje me kushtet e legjislacionit shqiptar për fondin rezervë të detyrueshëm.
- 23.3 Në bazë të Ligjit për Shoqëritë, Shoqëria mund të shpërndajë fitimin tek Ortakët vetëm nëse pas kësaj shpërndarje:
- a) Asetet e Shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e kësaj të fundit;
 - b) Shoqëria ka aktivë likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve të ardhshëm;
- 23.4 Administratori lëshon një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e pikës 23.3 më sipër. Ndërsa kur gjendja e Shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratori nuk mund ta lëshojë këtë certifikatë.
- 23.5 Administratori përgjigjet ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese.

Modifikimi i Formës Ligjore. Prishja e shoqërisë.

Neni 24

Modifikimi i Formës Ligjore

- 24.1 Forma ligjore e Shoqërisë mund të ndryshojë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme në përputhje me dispozitat respektive në Legjislacionin Shqiptar.
- 24.2 Shoqëria e re do të përmbushë të gjitha procedurat ligjore të regjistrimit në Shqipëri.

Neni 25

Prishja e Shoqërisë

25.1 Shoqëria mund të prishet në rrethanat e mëposhtme:

- a) si pasojë e përfundimit të kohëzgjatjes për të cilin ishte themeluar;
- b) me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
- c) hapje e një procedure falimentimi;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për 2 vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të Ligjit nr.9723, datë 3.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”;
- e) me vendim gjykate;
- f) për arsye të tjera të parashikuara nga Ortakët në cdo kohë.

25.2 Administratori regjistron prishjen e Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në përputhje me nenin 43 të Ligjit nr.9723, datë 3.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”. Në rast se prishja e Shoqërisë bëhet me vendim gjykate, gjykata, në përputhje me nenin 45 të Ligjit Nr.9723, datë 3.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, ia njofton vendimin kësaj të fundit për regjistrim.

Të Ndrvshme

Neni 26

Largimi i Ortakut

26.1 Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse:

- a) ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij;
- b) nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij;
- c) nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme;
- d) apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë.

26.2 Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtrojë shkaqet e largimit.

26.3 Administratori duhet të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme menjëherë pasi të kenë marrë dijeni për njoftimin e largimit, për të vendosur nëse Ortakut do t'i likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme.

26.4 Ortaku ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit Asambleja e Përgjithshme nuk mblidhet apo nuk e njeh si të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotës.

26.5 Ortaku që kërkon largimin nga shoqëria, detyrohet ta dëmshpërblejë shoqërinë për dëmet e shkaktuara, nëse rezulton se largimi është kryer në bazë të shkaqeve të paarsyeshme.

26.6 Ortaku që largohet ka të drejtë të ngrejë padi ndaj shoqërisë dhe/ose ortakëve të tjerë që shkaktuan largimin e tij dhe të kërkojë ndaj tyre, në mënyrë solidare, shpërblimin e dëmit të pësuar.

Neni 27

Përfundimi i Ortakut

27.1 Përfundimi i ortakut mund të bëhet në bazë të një vendimi të zakonshëm ku Asambleja e Përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës përfundimin e Ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të Statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përfundim.

27.2 Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e ortakut, sipas pikës 27.1 të këtij neni, por pa u kufizuar në to, rastet kur ortakut:

- a) me dashje apo me pakujdesi të rëndë i shkakton dëme shoqërisë ose Ortakëve të tjerë;
- b) me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel Statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj;
- c) përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut;
- d) ose me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të Shoqërisë.

27.3 Shoqëria ka të drejtë t'i kërkojë ortakut të përjashtuar shpërblimin e dëmit të pësuar nga veprimet, që kanë sjellë përjashtimin.

27.4 Ortaku ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë shpërblimin e dëmit të pësuar, nëse kërkesa për përjashtim nuk është e bazuar.

27.5 Ortaku nuk ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë likuidimin e kuotës, nëse ai përjashtohet për shkaqe të arsyeshme, por, nëse Shoqëria ngre ndaj tij padi për shpërblim dëmi, Ortaku ka të drejtë të kompensojë çdo shumë, që do të kishte të drejtë ta përfitonte në cilësinë e likuidimit të kuotës, me dëmin e kërkuar nga Shoqëria.

27.6 Pasojat e largimit dhe përjashtimit:

- a) Të gjitha të drejtat, që rrjedhin nga cilësia e Ortakut në Shoqëri, shuhet në datën e largimit ose të vendimit të formës së prerë të gjykatës për largimin ose përjashtimin.
- b) Statuti nuk mund të përjashtojë apo të kufizojë të drejtën e Ortakut për t'u larguar nga Shoqëria dhe të drejtën e Shoqërisë për të përjashtuar Ortakun.

Neni 28

Ligji i zbatueshëm

28.1 Ky Statut rregullohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 29

Të tjera


29.1 Çdo çështje tjetër, e cila nuk është përmendur në këtë Statut, do të rregullohet nga dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

ORTAKU THEMELUES I SHOQËRISË “NEVA INVEST GROUP” SHPK BIGALB GROUP SHPK

Z. Vullnet Sinaj

Person i Besuar

Znj. Valmira Dedgjoni



Tiranë, më datë 28/04/2025

